

Pozicion Vakant

Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Kompania Green Coast pjesë e Grupit Balfin është një kompani e fokusuar në projektimin, ndërtimin, vënien në shfrytëzim, administrimin, mirëmbajtjen, operimin e Resorteve Turistike, zhvillimit të Objekteve dhe Fshatrave Turistike dhe njësive të hotelerisë.

Pozicioni: Arkitekt

Departamenti: Teknik/Arkitekturë

Vendndodhja: Tiranë

Përmbledhja e Pozicionit: Arkitekti përpunon grafikët e projektit dhe raporton në strukturat përkatëse.

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Përpunon vizatime të planimetrive, volumetrive dhe detajeve të objekteve në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit dhe udhëzimeve të drejtuesve të projekteve;
- Mban lidhje të vazhdueshme me studiot e projektimit dhe drejtuesit e projektit;
- Krijon sipas udhëzimeve të drejtuesit të projektit skica paraprake, duke përdorur software projektimi si (CAD, SketchUp), të cilat sugjerojnë formën dhe pamjen e përgjithshme të ndërtesës;
- Shkëmben informacion të nevojshëm dhe koordinohet me DA, Arkitektin e projektit, PM, Departamentin e shitjeve dhe Administrimit, si dhe me drejtuesit e ekipeve të zbatimit në terren;

- Përgatit në kohë vizatime sipas kërkesave;
- Përgatit vizatimet arkitekturore për t'i përfshirë në paketat e tenderimit, sipas natyrës së tij;
- Njihet me zbatimin e projektit në terren, të projekteve në zhvillim të kompanisë dhe me strukturën e kompanisë në tërësi;
- Lexon projektet e të gjitha disiplinave, raportet dhe specifikimet teknike për objektet në zhvillim;
- Mbikëqyr cilësinë dhe afatet e punimeve arkitekturore dhe materialeve;
- Hartimi i raporteve javore për punën individuale;
- Detyra të tjera që mund t'i ngarkohen;

Edukimi: Të zotërojë diplomë universiteti në Arkitekturë;

Kualifikime të tjera:

- Preferohet të ketë deri në 3 vite eksperiencë në këtë fushë;
- Aftësi mbi çështje të skemave organizative e funksionale të objekteve dhe detajeve të rifiniturës;
- Aftësi për të koordinuar projektin me punët e disiplinave të tjera, si: Konstruksion, Elektrik, Mekanik;
- Aftësi për të punuar në skuadër;
- Njohje shumë e mirë e Gjuhës angleze;
- Përdorimi i paketës Auto Cad, SketchUp, 3D Max, Microsoft Office, Adobe Photoshop;

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre dhe letrën e motivimit në adresën hr@greencoast.al me subjekt **GC Architect _ 0921**

Afati i dorëzimit: 28/09/2021

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr. 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*